



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 164, datë 31.10.2025**

**PËR  
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUTIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT  
“SiCRED” SH.A. DHE MIRATIMIN E Pjesëmarrjes INFLUENCUESE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 48 dhe 57 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Rregullores nr. 138, datë 21.12.2015 “Për miratimin ose refuzimin e ndryshimeve thelbësore të statutit të shoqërisë së sigurimit”, si dhe Rregullores nr. 1, datë 25.01.2016 “Për procedurat dhe mënyrën e depozitimit të informacionit dhe dokumentacionit në lidhje me burimin e kapitalit për aksionarët e shoqërisë së sigurimit”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e ndryshimit të pikës 3, të nenit 6, të statutit të shoqërisë së sigurimit “SiCRED” sh.a. për shkak të ndryshimit të strukturës aksionare, si rezultat i futjes së aksionarit të ri personit juridik-“BFSE Holding B.V.”, i cili ka blerë të gjitha aksionet që zotëronin në kapitalin e shoqërisë së sigurimit “SiCRED” sh.a. zj. Monika Milo (4.75 %), z. Maltin Korkuti (4.75 %), z. Renis Tërshana (30.16 %) si edhe blerjes së 9.52 % të aksioneve nga totali prej 46.39 % që z. Aleksandër Pilo zotëron në kapitalin e shoqërisë së sigurimit SiCRED sh.a.**
- 2. Miratimin e pjesëmarrjes influencuese të aksionarit shoqëria “BFSE Holding B.V.” me 49.18 % të kapitalit të shoqërisë së sigurimit “SiCRED” sh.a.**
- 3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit e këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR  
Saimir TOLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV  
Mimoza KAÇI**